



Rregullorja e Procedurës dhe e Provave (RRPP) e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) është një tërësi dispozitash të detajuara që rregullojnë zhvillimin e procedurave para DHSK-së. Ndërsa Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") përcakton parimet themelore që drejtojnë veprimtarinë gjyqësore të DHSK-së (i ngjashëm me një kod penal), qëllimi i Rregullores është që t'i konkretizojë këto parime dhe mbi këtë bazë, të parashtrorë procedurën e saktë që duhet ndjekur në secilën fazë të procedurave para DHSK-së (e ngjashme me një kod të procedurës penale). Në tërësi, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave synon të përmirësojë drejtësinë, shpejtësinë, efikasitetin, ndershmërinë dhe sigurinë e procedurave para Dhomave të Specializuara. Rregullorja është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin dhe pasqyron standardet më të larta të të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Më poshtë vijojnë pjesë të zgjedhura nga Rregullorja.

STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI I DHSK-SË

Gjykatësit e Dhomave të Specializuara përfshihen në një Regjistër dhe caktohen nga Kryetari në çështje konkrete, ose për të ushtruar funksione të tjera të parashikuara në Ligj. RRPP-ja parashtron arsyet për vetëtërheqjen ose përjashtimin e gjykatësve në rast konflikti interesash, ose kur vihet në dyshim paanshmëria, pavarësia gjyqësore, ose ndershmëria e gjykatësve. Kryetari i DHSK-së është përgjegjës për administrimin gjyqësor të DHSK-së. Kryetari gjithashtu shërben si kryetar i çdo paneli të Gjykatës Supreme ku është anëtar. Administratori është përgjegjës për administrimin dhe shërbimet për Dhomat e Specializuara. Avokati i Popullit ka detyrën e monitorimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të personave që kanë punë me DHSK-në dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Sidoqoftë, Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë në procedura ligjore, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.

MASAT PËR GARANTIMIN E DREJTËSISË, SIGURISË DHE SHPEJTËSISË SË PROCEDURAVE

Prej DHSK-së kërkohet që të procedojë të gjitha çështjet në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë. Në bazë të Rregullores, gjykatësit kanë afate të përcaktuara për nxjerrjen e vendimeve dhe prej tyre kërkohet të përcaktojnë kalendarë dhe plane pune për të siguruar efektshmërinë dhe efikasitetin e procesit gjyqësor. Gjykatësit kanë kompetenca të veçanta për të ndërmarrë masa për përshpejtimin e procedimit të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë (si frikësimi i dëshmitarëve, falsifikimi i dokumenteve, provat dhe dëshmitë e rreme etj.).

Ekzistojnë gjithashtu edhe dispozita për masa mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat pjesëmarrëse në procedura gjyqësore. Disa prej masave të mundshme janë dhënia e dëshmisë me pseudonim, me ndryshim të zërit ose të pamjes, dhe seancat private, ose me dyer të mbyllura. Për dëshmitarët e traumatizuar ose të cenueshëm, personat e moshuar ose ata nën moshën 18 vjeç, zbatohen masa të posaçme si prania e një psikologu, këshillëdhënësi, ose anëtarit të afërt të familjes, gjatë dhënies së dëshmisë.

ARRESTIMI DHE PARABURGIMI

Personi i cili privohet nga liria në bazë të një urdhri të Prokurorit të Specializuar apo të gjykatësve, duhet të informohet për arsyet e paraburgimit dhe të nxirret para gjykatësve pa vonesë të papërligjur. Personit i sigurohen gjithashtu të gjitha garancitë themelore sipas Kushtetutës së Kosovës dhe të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për një mbrojtës. Rregullorja parashikon rishikime të herëpashershme nga gjykatësit të përshtatshmërisë së paraburgimit dhe mbajtjes së mëtejshme në paraburgim. Gjithashtu, Rregullorja përcakton periudhën maksimale të mbajtjes në paraburgim në fazën e hetimit (një vit).

Personi i paraburgosur ka të drejtë të apelojë vendimin e paraburgimit drejtpërsëdrejti para panelit të Gjykatës së Apelit dhe, në shkallë të fundit, para panelit të Gjykatës Supreme. Ekziston mundësia e zhdëmtimit për arrestim dhe paraburgim të paligjshëm - çdo person mund t'i paraqesë Kryetarit një kërkesë të tillë brenda gjashtë muajsh pas daljes së vendimit të formës së prerë që konstaton arrestim ose paraburgim të paligjshëm.

Pas transferimit në DHSK, i dyshuari nxirret para një gjykatësi, pa vonesë të papërligjur, për rishikimin e ligjshmërisë së arrestimit ose paraburgimit. Vendimi i gjykatësve jepet brenda 48 orësh.

AKTAKUZA DHE PROCEDURA PARAPRAKE

Procedura paraprake fillon kur Prokurori i Specializuar dorëzon aktakuzën për shqyrtim prej gjykatësit të procedurës paraprake. Aktakuza konfirmohet vetëm nëse dorëzohen prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzave. Në këtë rast, i akuzuari nxirret para gjykatësit të procedurës paraprake ku mund të vetëdeklarohet i pafajshëm ose të pranojë fajësinë. Në rast se i akuzuari vetëdeklarohet i pafajshëm, çështja kalon në fazën e procedurës paraprake, kurse në rast se pranon fajësinë, çështja kalon në fazën e dhënies së dënimit. Nëse aktakuza nuk konfirmohet, çështja rrëzohet. Gjykatësi i procedurës paraprake duhet të marrë vendim edhe për çdo mocion paraprak dhe të sigurojë që procedura paraprake të mos ketë vonesa të papërligjura dhe çështja të përgatitet për gjykim si duhet.

PROCEDURAT E GJYKIMIT/APELIT/GJYKATËS SUPREME

Çdo palë ka të drejtën të paraqesë prova që kanë lidhje me çështjen. Përveçse kur urdhërohet ndryshe nga trupi gjykues, provat paraqiten në renditjen e mëposhtme: prova të Prokurorit të Specializuar, prova të Mbrojtjes, prova të kërkuara nga trupi gjykues, kundërprova të Prokurorit të Specializuar, kundërprova të Mbrojtjes. Pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, Mbrojtja mund të dorëzojë mocion për rrëzimin e ndonjë akuze, apo të të gjitha akuzave kundër të akuzuarit. Më tej, që në këtë fazë trupi gjykues mund ta rrëzojë aktakuzën, nëse nuk ekzistojnë prova në mbështetje të një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm. Vendimi i gjykimit përgjithësisht shqiptohet brenda 90 ditësh pas mbylljes së çështjes gjyqësore. Të dyja palët mund ta apelojnë aktgjykimin. Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjë apel në lidhje me statusin e viktimave, ose zhdëmtimin. Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta lerë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë aktgjykimin e gjithashtu mund të urdhërojë rigjykim. Personi i shpallur fajtor mund ta apelojë aktgjykimin e panelit të Gjykatës së Apelit, e në një rast të tillë çështja i kalon panelit të Gjykatës Supreme. Gjithsesi, paneli i Gjykatës Supreme shqyrton vetëm ato apele në të cilat paneli i Gjykatës së Apelit ka rrëzuar vendimin e pafajësisë dhe në vend të tij ka dhënë një vendim fajësie kundër të akuzuarit, ose nëse është dhënë dënim me burgim të përjetshëm.

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave (Rregullorja) u miratua më 17 mars 2017 dhe u rishikua më 29 maj 2017 nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara. Pas aktvendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) se Rregullorja është në pajtim me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, ajo hyri në fuqi më 5 korrik 2017, data kur Dhomat e Specializuara u bënë funksionale në aspektin gjyqësor. Më 26 maj 2020, DHSGJK-ja konstatoi se 30 ndryshimet e Rregullores të miratuara nga gjykatësit ishin në pajtim me Kapitullin II të Kushtetutës. Rregullorja e ndryshuar hyri në fuqi shtatë ditë më pas.

NDRYSHIMI I RREGULLORES

Gjykatësit, Prokurori i Specializuar, Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar (i krijuar për të përfaqësuar interesat e Mbrojtësve që veprojnë para DHSK- së) dhe Administratori mund të propozojnë ndryshime në Rregullore. Ndryshimet e propozuara shqyrtohen nga Komisioni për Rregulloren, i përbërë prej Kryetarit dhe dy gjykatësve të tjerë të caktuar nga Kryetari. Propozimet miratohen nga seanca plenare e gjykatësve, me shumicë absolute të gjykatësve pjesëmarrës.

DHOMA E SPECIALIZUAR E GJYKATËS KUSHTETUESE

Referimet në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese mund të bëhen nga gjykatësit, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe Avokati i Popullit i Kosovës. Referime mund të bëhen edhe nga individët, përfshirë të akuzuarin dhe viktimat, por vetëm pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të parashikuara në ligj.

PJESËMARRJA E VIKTIMAVE NË PROCEDURË

Rregullorja përmban procedurën për pranimin dhe pjesëmarrjen në procedurë të viktimave të krimeve në ngarkim të të akuzuarve. Për përmbushjen e kushteve të pranimit si viktimë para DHSK-së, kërkuesi duhet të paraqesë prova të mjaftueshme për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të përfshirë në aktakuzë. Në marrjen e vendimit për pranimin dhe modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave, gjykatësit duhet të garantojnë që kjo të mos ndikojë në kryerjen e një procedure të drejtë dhe të shpejtë, në tërësi. Viktimat pjesëmarrëse i ushtrojnë të drejtat e tyre si grup gjatë të gjitha fazave të procedurave gjyqësore, përmes një Mbrojtësi të Viktimave që u caktohet. Mbrojtësi ka të drejtën të bëjë deklarata hyrëse dhe përmbyllëse, dhe mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake dhe të gjykimit, nëse trupi gjykues e shih të arsyeshme për mbrojtjen e interesave personale dhe të drejtave të viktimave.

ZHDËMTIMET

Trupi gjykues mund ta referojë çështjen në padi civile, ose të japë urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor. Në rastin e dytë, trupi gjykues mund të emërojë ekspertë për ta ndihmuar në përcaktimin e masës së dëmit shkaktuar viktimave.